



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 11, 17 shkronja k) dhe 40.2 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenin 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/l-049, nenet 14 dhe 19 paragrafi 1.11 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Rregulloren (komunale) për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte nr.prot01/111-400 të datës 28 maj 2012 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Rregulloren nr.prot.01/172-400 të datës 27 shtator 2012, si dhe në bazë të Programit trevjeçar të banimit 2019-2021 në Komunën e Podujevës i miratuar me Vendimin nr.prot.01-360/01-0060753/19 të datës 29 korrik 2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2020, miratoi,

### **VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

#### **Neni 1**

Ndahen mjete financiare në shumë 130,000.00 €, me destinim për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare sipas nenit 1, janë dispozicion për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive të banimit dhe të njëjtat mund të barten në llogarinë e Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” me të cilën Komuna e Podujevës ka lidhë Marrëveshje Bashkëpunimi për bashkëfinancim.

#### **Neni 3**

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria subvencione dhe transfere, kodi buxhetor 200.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e vendimit kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### **Neni 5**

Pas miratimit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

**Nr.01-020/04-0032340/20**  
**Podujevë,**  
**30 qershor 2020**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**